



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Prilbena / Prodato Received / Delivery	22-12-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMISHKIC	8367/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.964/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.964/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga ankuesja

Komuna e Kamenicës, kundër Vendimit me numër protokollit 02/33025 të datës 12.10.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.964/2022 e datës 31.10.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër:02/33025 i datës 12.10.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Kamenicës.

A r s y e t i m

Ankuesja, Vlora Vojvoda, me datë 31.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6586/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.964/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 02/33025 të datës 12.10.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Kamenicës, me pretendimet ankimore së vendimi në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar ankesën për përgjigje në Komunën e Kamenicës, ndërsa me datë 15.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin VK.nr.191 të datë 15.12.2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjen lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) dite pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 31.10.2022, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 31.10.2022 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.11.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 15.11.2022; Konkursin e datës 24.08.2022; Listën e aplikantëve; Njoftimin për Veprimin paraprak i datës 20.09.2022; Aplikacionin e ankueses të datës 09.09.2022; Vendimin e datës 21.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Akt emërimit e datës 19.07.2022; Akt emërimit e datës 15.09.2011; Akt emërimit e datës 20.03.2020; Akt emërimit e datës 15.09.2017; Akt emërimit e datës 04.12.2019; Komentet e vlerësimit të kandidatës nga ana e anëtarëve të Komisionit; Lista e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 04.10.2022; Njoftimin e datës 05.10.2022; Ankesa e ankueses e parashtruar në Komisionin e Pranimit; Vendimin e Komisionit për Vlerësimin për Lëvizjen Brenda Kategorisë i datës 12.10.2022; Deklaratën e kryesuesit të Komisionit e datës 10.11.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses Vlora Vojvoda , *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Kamenicës, me datë 24.08.2022 ka shpallur konkurs për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Arsim* me numër reference RN00009814 (*lëvizje brenda kategorisë*). Rrjedhimisht, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë është konstatuar se ankuesja në konkursin përkatës ka aplikuar me datë 09.09.2022 me numër të aplikacionit RAN0007775, ndërsa sipas Njoftimit për verifikimin paraprak të datës 20.09.2022 të nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, konstatohet fakti se ankuesja ishte e vetmja kandidate në këtë procedurë.

Ankuesja i është nënshtruar intervistimit me gojë për pozitën në të cilën kishte aplikuar, dhe sipas Listës për renditjen përfundimtare të kandidatëve, e njëjta ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 32.4 pikë. Andaj, duke qenë se ankuesja nuk ka arritur piket e nevojshme për të qenë kandidate e suksesshme, Komisioni për Vlerësim me datë 05.10.2022 ka nxjerrë Njoftimin lidhur me përfundimin e procedurës për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Arsim* me numër reference RN00009814.

Kundër vlerësimit përfundimtar të Komisionit të Vlerësimit, ankuesja ka parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Komisioni në fjalë me datë 12.10.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 02/33025 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar në ligj

ndërsa ka lënë në fuqi rezultatin e vlerësimit përfundimtar të shpallur në HRMIS për pozitën me numër reference RN00009814.

Me datë 31.10.2022 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër:02/33025 të datës 12.10.2022 të Komisionit të Vlerësimit, me pretendimet ankimore së vendimi në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankueses analizoi dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 47, ku përcaktohet se: 1. KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2. Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi; 3. KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës; 4. Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë, dhe rrjedhimisht duke ju referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht formularit të vlerësimit në sistemin e HRMIS konstatoi faktin se të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit e kanë vlerësuar në mënyrë individuale ankuesen siç përcaktohet edhe me nenin 48 paragrafi 1 te të njëjtës rregullore, ku parashihet se: *Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë*", ndërsa nga mbledhja e rezultatit të përgjithshëm nga vlerësimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit rezulton se ankuesja ka arritur që t'i mbledh gjithsejtë 32.4 pikë.

Andaj, duke ju referuar dispozitave të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 49 paragrafi 2, ku përcaktohet se: 2. *Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi*, dhe pas vërtetimit të faktit se ankuesja nga mbledhja e rezultatit të përgjithshëm është vlerësuar me gjithsejtë 32.4 pikë, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses është e pabazuar, ngase për konkurset e shpallura të tipit *Lëvizje Brenda Kategorisë*, emërohen vetëm kandidatët që kanë arritur pikë maksimale, por jo me pak së 60 pikë, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njoftimi i datës 05.10.2022 i nxjerrë nga Komisioni i Vlerësimit, lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Arsim* me numër reference RN00009814 është në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material me të cilat rregullohen procedurat e rekrutimit ngase ankuesja nuk kishte arritur të kalojë pragun minimal prej 60 pikësh.

Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore të ankueses se ndaj të njëjtës nga anëtarët e komisionit të vlerësimit është ushtruar presion psikik dhe është tentuar që e njëjta të incizohet gjatë intervistimit, Kolegji i Këshillit thekson faktin se çështjet e natyrës së tillë nuk hynë në kuadër të fushëveprimt funksional të Këshillit, dhe se për çështje të tillë pala duhet t'iu drejtohet organeve kompetente siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.964/2022

Elakron GASHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

